



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/01/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga W.I.K LLC, me përfaqësues sipas autorizimit R.M, për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares L.A.K, bazuar në dispozitën e Nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 22.01.2024 merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga W.I.K LLC, me përfaqësues sipas autorizimit R.M, ndaj gjyqtares L.A.K për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

W.I.K LLC, me përfaqësues sipas autorizimit R.M me datë 09.01.2024 ka ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares L.A.K. Me datë 11.01.2024 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës të parashtruesit.

Parashtruesi i ankesës ka parashtruar ankesë me pretendimet se gjyqtarja L.A.K ka bërë shkelje disiplinore sipas nenit 5 par. 1.2 dhe 1.3 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sepse e njëjta ka shkelur ligjin dhe detyrat e saj zyrtare si gjyqtare. Sipas parashtruesit të ankesës, me datë 31.07.2023 në mbështetje të dispozitave ligjore ka paraqitur kërkesë që të përfshihet si palë e interesit në çështjen gjyqësore administrative A.nr.1962/20, sepse ka qenë e pajisur me pëlqimet përkatëse të cilat janë anuluar përmes vendimit 01Nr.8940/20 të datës 05.03.2020 të Komunës së Klinës. Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative ka nxjerrë Aktvendimin A.nr.1962/20, me anë të cilit e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e parashtruesit. Parashtruesi i propozimit, këtu parashtruesi i ankesës, me datë 07.09.2023 me datë 07.09.2023 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative ka paraqitur kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit 01Nr.8940/20 të datës 05.03.2020, kërkesë kjo e cila është hedhur poshtë me Aktvendimin A.nr.1962/20 nga gjyqtarja e çështjes. Lidhur me këtë, parashtruesi i propozimit ka paraqitur ankesë brenda afatit ligjor në Gjykatën e Apelit, meqë rast Gjykata e Apelit me vendimin AA.nr.843/2023 e ka miratuar të bazuar ankesën dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje. Gjyqtarja e çështjes, me datë 04.12.2023 ka nxjerrë aktvendimin me të cilin e ka hedhë poshtë kërkesën e

datës 07.09.2023 për rishikimin e aktvendimin A.nr.1962/20 dhe shtyrje të ekzekutimit të vendimit të datës 05.03.2020. Sipas parashtruesit të ankesës, gjyqtarja e çështjes e ka hedhur poshtë propozimin përkundër konstatimit të qartë të Gjykatës së Apelit se mos përfshirja e Parashtruesit si palë e interesuar paraqet shkelje esenciale të dispozitave ligjore. Ndër të tjerash, parashtruesi i ankesës ka deklaruar se gjyqtarja e çështjes L.A.K, në pjesën e arsytimit të aktvendimit A.nr.1962/20 të datës 04.12.2023 ndër të tjera ju ka referuar parashtruesit me fjalën “ *mashtruesi* ”, e cila përbën shkelje të rëndë të parimeve bazë të Kodit të Etikës Profesionale të gjyqtarit dhe se përdorimi i termeve të natyrës së tillë në fjalorin e një gjyqtari është rreptësishtë i ndaluar dhe është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas të njëjtit, gjyqtarja e çështjes me këtë shprehje ka paragjykuar dhe kjo nuk garanton drejtësi në trajtimin dhe vendosjen e kësaj çështje, duke cenuar të drejtën e parashtruesit për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Ndër të tjerash, parashtruesi i ankesës ka deklaruar se edhe nëse gjyqtarja e ka përdorur këtë term nga pakujdesia e rëndë dhe nuk e ka bërë me dashje, ajo si gjyqtare është dashur të lexojë me vëmendje aktvendimin dhe të mos lejojë një ofendim të tillë në një dokument publik. Andaj, në bazë të të lartcekurave, i ka propozuar gjykatës që të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës fillimin e hetimeve disiplinore.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të ankesës, gjyqtarja L.A.K ka deklaruar se sa i përket ankesës dhe përgjigjes ndaj të njëjtës dhe pretendimeve rreth vendimmarrjes si gjyqtare e çështjes referim kryesor e ka bazën ligjore dhe sa i përket vendimeve të njëjtat atakohen në Gjykatën e Apelit ashtu siç ka vepruar parashtruesi me propozimin. Sa i përket termit të përdorur në vendim “*mashtruesi*”, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se i gjithë vendimi referohet *parashtruesi* andaj referuar për vjedhjes së gabimit teknik referuar korrigjim nga fjalori i njëjti gabim në shkrim është identifikuar nga Gjykata po në ditën e nxjerrjes së vendimit dhe është korrigjuar-përmirësuar në kuptim të nenit 165 të LPK (165.1 Gabimet në emra dhe numra, si dhe *gabimet tjera në shkrim* dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, *i korrigjon gjykata në çdo kohë*) *me shkrimin parashtruesi* ashtu siç është evidentuar si referim në gjithë shkrimin në vendim dhe aktvendimi për korrigjim i është bashkangjitur në lëndë vendimit i cili është ekspeduar tek palët. Po ashtu e njëjta ndër të tjera ka deklaruar se lidhur me këtë çështje ka hartuar dhe shënimin zyrtar dhe e ka vendosur në shkresa të lëndës (veprime këto të evidentuara në lëndë). Sipas saj lënda tashmë gjendet në Gjykatën e Apelit për vendosje lidhur me ankesën.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit së ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares L.A.K.

Lidhur me pretendimet për vendimet e marra nga gjyqtarja e çështjes gjatë trajtimit të lëndës gjyqësore, Kryetarja e Gjykatës nuk ka kompetencë të vlerësoj vendimmarrjen e gjyqtarëve lidhur me propozimet e paraqitura nga palët në procedurë, a po nëse këto veprime të gjyqtarit bien ndesh me dispozitat ligjore, pasi që për shkelje të dispozitave ligjore vendos shkalla më e lartë me rastin e atakimit të vendimit. Mënyra e vendosjes lidhur me propozimet e palëve në procedurë, janë në kompetencë ekskluzive të gjyqtarit të çështjes dhe si të tilla nuk mund të jenë rrethana për fillimin e një procedure disiplinore.

Ndërsa, nuk është kontestues fakti se gjyqtarja e çështjes në aktvendimin A.nr.1962/20 të datës 04.12.2023 ka përdorur termin “*mashtrues*” ashtu siç edhe po pretendon parashtruesi i ankesës.

Mirëpo, në bazë të shikimit të vendimit shihet qartë se gjyqtarja e çështjes në tërësi i është referuar palës prozuesuese me “*parashtruesi*”, gjë e cila lë të nënkuptoj se gjyqtarja e çështjes nuk ka pasur tendencë fyerje a po mos respekti për palën prozuesuese dhe se fjala “*mashtruesi*” ka qenë një gabim shkrimor, i cili posa është vërejtur është përmirësuar nga gjyqtarja e çështjes me aktvendim për korigjim.

Në çdo kohë, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës, gjyqtarët mund të korigjojnë gabimet drejtshkrimore, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të ngjashme, të dukshme në një vendim gjyqësor.

Ligji për Procedurën Kontestimore neni 165 par. 1 i njeh të drejtën gjyqtarëve që në çdo kohë të korigjojnë gabimet në emra dhe numra, gabimet tjera në shkrim a po llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit a po mospajtim të kopjes me origjinalin e aktgjykimit.

Për korigjimin e aktgjykimit gjykata vendos pa dëgjimin e palëve dhe kundër aktvendimit me të cilin bëhet korigjimi i aktgjykimit lejohet ankesë e veçantë.

Duke marrë parasysh se gabimet të cilat janë bazë e korigjimit të aktvendimit nuk janë rezultat i formulimit të gabuar të vullnetit të gjykatës në kohën e dhënies së vendimit, kjo sepse me anë të korigjimit nuk mund të ndryshohet vullneti i gjykatës i formuar me rastin e dhënies së vendimit, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, për t’i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/01/24, me datë 22.01.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë